




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-1250/15
Nr. l faq. Broj stranica 04	Data Datum 30.04.2015
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	30/04/2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP – 03-03/585/15
PËR/ZA/TO:	z. Afrim MAXHUNI Drejtor i Departamentit të Prokurimit dhe Kontratave në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës
CC:	z. Shkëlzen SYLA Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Furnizim Automjete Taktike për nevoja të FSK-së”

I nderuar z. MAXHUNI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Furnizim Automjete Taktike për nevoja të FSK-së” me numër prokurimi: 21700/15/013/111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik “Furnizim Automjete Taktike për nevoja të FSK-së” me numër prokurimi: 21700/15/013/111, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, bazuar në nevojat e saj për Furnizim me Automjete Taktike për nevoja të FSK-së, ka paraparë aktivitetet prokurimi me Procedurë të Hapur. Ky aktivitet është shpallur më datë: 25/02/2015 në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion në përputhje me misionin e saj ka vlerësuar që të jetë pjesë e monitorimit (si vëzhgues) të këtij aktiviteti të prokurimit. Si rrjedhojë Agjencia ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm dhe ka njoftuar Autoritetin Kontraktues se Agjencia do të jetë pjesëmarrëse në vëzhgim gjatë punës së komisionit vlerësues.

Pas vëzhgimit të procesit të vlerësimit të datës 15 dhe 17 Prill, Agjencia Kundër Korrupsion ka konstatuar se procesi i vlerësimit ka qenë i rregullt dhe nuk ka pasur ndonjë parregullsi që mund të ndikonte në vlerësimin objektiv të komisionit. Në aktivitetin e prokurimit për Furnizim me Automjete Taktike, për nevoja të FSK-së kanë ofertuar katër Operator Ekonomik. Dy nga katër ofertues, kanë qenë grup i Operatorëve Ekonomik.

Në fund të procesit të vlerësimit të ofertave, Agjencia ka konstatuar se vetëm njëri nga Operatorët Ekonomik është i përgjegjshëm.

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar që të ofrohet: "Autorizimi nga prodhuesit apo dileri i autorizuar nga prodhuesi për shitjen e këtyre automjeteve. Autorizimi duhet të jetë me emër të projektit, numër të prokurimit, data e lëshimit, adresën elektronike, numrin e telefonit si dhe të jetë i nënshkruar dhe vulosur në origjinal ose në kopje të noterizuar. Njëri nga Operatorët Ekonomik në konzorciumin që ka aplikuar në këtë aktivitet prokurimi ka përfaqësinë e një prodhuesi të caktuar të automjeteve, ndërsa operatori tjetër, i cili nuk ka autorizim për shitje dhe servisim është lider i grupit. Lideri i grupit i cili nuk ka autorizim nga prodhuesi, ka ofruar marrëveshje me përfaqësuesin e prodhuesit për servisimin e automjeteve që i ofron.

Autoriteti Kontraktues, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës është furnizuar disa herë me Automjete për nevoja të FSK-së. Automjetet kryesisht kanë qenë taktike dhe jo-taktike. Shqetësuese për Agjencinë Kundër Korrupsion është fakti që çmimet e ofruara janë të larta në krahasim me çmimet e tregut. Në vitin 2012 Autoriteti Kontraktues është furnizuar me Automjete taktike me çmim më të volitshëm sesa që janë ofruar tani. Për dallim nga procedura e tanishme, në aktivitetin e vitit 2012, Autoriteti Kontraktues kishte zhvilluar procedurë të negociuar pa publikim.

Kronologjia e aktiviteteve të prokurimit për Automjete Taktike dhe Jo-Taktike për nevojat e FSK-së është me sa vijon: Më 06/09/2011, për tenderin Furnizim me Automjete Taktike për Nevoja të FSK-së MFS21700/11/074/111, me procedurë të hapur është shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik që ka ofertuar me prodhimet e llojit, Mercedes. Më 29/08/2012 për tenderin Furnizim me Automjete Taktike për Nevoja të FSK-së MFS21700/12/005/115, me procedurë të negociuar pa publikim është shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik që ka ofertuar me prodhimet e llojit Land Rover DEFENDER 4x4. Më 01/10/2012 për tenderin Furnizim me Automjete Jo - Taktike për Nevoja të FSK-së MFS21700/12/021/111, me procedurë të hapur është shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik që ka ofertuar me prodhimet e llojit Land Rover 4x4. Më 06/08/2013, për tenderin Furnizim me Automjete Taktike të standardizuara (xhipa Mercedes Benz) për Nevoja të FSK-së MFS21700/13/040/111, me procedurë të hapur (revokim neni) është shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik që ka ofertuar me prodhimet e llojit Mercedes. Më 04/09/2014 për tenderin Furnizim me Automjete Taktike për Nevoja të FSK-së MFS21700/14/004/111, me procedurë të hapur (revokim neni) është shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik që ka ofertuar me prodhimet e llojit Land Rover DEFENDER 4x4.

Të pesë rastet e Furnizimeve me Automjete Taktike dhe Jo-Taktike, Autoriteti Kontraktues është furnizuar me çmime të ndryshme dhe ka zhvilluar procedura jo të njëjta. Në tre nga pesë rastet ka bërë revokim nenesh, me që ka pasur vetëm nga një Operator Ekonomik të përgjegjshëm. Në njërin rast Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedurë të hapur ku ka shpërblyer me kontratë njërin nga dy Operatorin Ekonomik të përgjegjshëm, me çmimin më të ulët. Në njërin aktivitetet për Automjete të tilla, Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedurë: - "E negociimit pa publikim" dhe është furnizuar me Automjetet përkatëse.

Analizuar pesë rastet e lartë përmendura del se vetëm në njërin aktivitet, Autoriteti Kontraktues kishte zgjedhur procedurën e përshtatshme, kur ka shpërblyer me kontratë njërin nga dy operatorët Ekonomik të përgjegjshëm, i cili ka ofertuar me çmim më të ulët. Agjencia Kundër Korrupsion, konsideron se një procedurë e tillë do të ishte më efikase për ruajtjen e buxhetit publik të vendit, duke i dhënë hapësirë më të madhe konkurrencës së tregut.

Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, Autoriteti Kontraktues duhet ti kushtoj rëndësi të veçantë Dosjes së Tenderit dhe t'i formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë të tillë që nuk përjashton operatorët ekonomik të cilët posedojnë në një shkallë të kënaqshme me mundësitë ekonomike, financiare dhe teknike.

Agjencia Kundër Korrupsion konstaton gjithashtu se nëse gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, pranohen më pak se dy tenderë të përgjegjshëm autoriteti kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit.

Agjencia rekomandon Autoritetin Kontraktues që të zgjedh procedurat më të përshtatshme për furnizime të tilla, në mënyrë që mos të lihet hapësirë për keqpërdorime të mundshme dhe të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë aktivitetit të prokurimit, pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për operatorët furnizues ose furnizuesit potencial.

Agjencia do të monitoroj deri në fund përfundimin e këtij aktiviteti dhe do ti qaset hetimeve në çdo kohë që konsideron se është e nevojshme.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !